

12 nentor, u zhvillua takimi i perjavshëm me katekistet e Mitropolisë së Elbasanit



Sot më dt. 12 nentor, u zhvillua takimi i perjavshëm me katekistet e Mitropolisë së Elbasanit. Ky takim filloi me shërbesën e Paraklisit, drejtuar Zonjës Shën Mari, për shëndetin e Kryepiskopit Anastas. Lutemi që ta kalojë sa më lehtë këtë sfidë dhe të kthehet sa më parë pranë nesh!

Më pas takimi vijoi me një referatë mbajtur nga profesori dhe teologu z. Dhimitër Qosja. Ai referoi për temën më aktuale të ditëve të sotme, për virusin Covid 19, për mënyrën sesi e interpreton Kisha. Ndër mesazhet e shumta që ai përcolli, spikati me frazën: ndërgjegjësohuni dhe qendrojini pranë të afërmve tuaj me shumë dashuri, sepse së bashku mund të kalojmë çdo gjë më lehtë, aq më tepër kur ketë gjë e bëjmë në emër të Zotit tonë Jisu Krisht. Mënyra më e mirë për ta kaluar këtë situatë është të lutemi për vete dhe për njëri-tjetrin gjithashtu të tregohemi të kujdesshëm. Perëndia na premtoi që nuk do të na braktisë deri në fund të jetës. Amin!





[Katekizmi i Krishterë – Mitropolia e Elbasanit, Shpatit dhe Librazhdit](#)